



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:156491

Datë: 24.12.2023

Numri i dokumentit: 05116493

P.nr. 569/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi - Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit J. Th. nga fsh. G.K.P, i akuzuar për shkak të veprës penale *sulmi* nga neni 184 par. 2 të KPRK-së dhe veprës penale *kanosje* nga neni 181 par .1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 1269/23, të datës 17.07.2023 pas mbajtjes së seancës jopublike të shqyrtimit fillestar me datë 12.12.2023, në praninë e prokurorit të shtetit L. H, të pandehurit J. Th., së bashku me mbrojtësin e tij av. F. B, sipas autorizimit, të dëmtuarës A. Th, mbrojtëses së viktimave Z.B, në të njëjtën ditë bie dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 24.12.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

J. (M.) TH, i lindur me datë ..., në fsh. G. K. P, i lindur nga babai M. Th. dhe nëna P. Th, e vajzërisë K, i identifikuar në bazë të numrit personal....., ka të përfunduar shkollën e mesme, i gjendjes së ulët ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e

I. Me datë 27.06.2023, rreth orës 18:00 min, në fsh. G .K. P, pikërisht në shtëpinë e tij, brenda marrëdhënies familjare, sulmon tjetrin dhe atë bashkëshorten tij, të dëmtuarën A. Th, në atë mënyrë që ditën kritike (pas një mosmarrëveshje që kishin pasur në mes veti , i pandehuri i drejtohet me fjalët’’ a don me qëndru në shtëpi, gjatë gjithë kohës do ta përjetosh të njëjtën dhunë, apo do të shkosh në shtëpinë e babait tënd’’ pastaj e kap për fyti të njëjtën, duke e shtrënguar me dy duar i’a vështirëson frymëmarrjen, por aty ndërhyjnë djali i tyre i cili e largon babin nga nëna e tij, pastaj e dëmtuara me fëmijët largohet nga shtëpia dhe shkon tek prindërit e saj.

- me çka ka kryer veprën penale “ *sulmi* ” nga neni 184. par.2, të KPRK-së,

II. Me datë 08.09.2023, rreth orës 10:48 min, në P, pikërisht në shtëpinë e gjyshit të të dëmtuarit, brenda marrëdhënies familjare përmes telefonit, seriozisht kanos tjetrin dhe atë të dëmtuarit djalin e tij J. Th, në atë mënyrë që, pasi që bashkëshortja edhe fëmijët e të pandehurit kishin shkuar në shtëpinë e babait të saj, për shkak të mosmarrëveshjeve që kishin (si në dispozitivin e parë) i pandehuri përmes telefonit kontakton të dëmtuarin J., dhe kërkon që të kthehen në shtëpi, por pasi që i dëmtuari nuk pranon që të kthehet, i pandehuri e kanos me fjalët ‘’ për tri ditë nëse nuk dilni nga shtëpia e gjyshit dhe nuk ktheheni në shtëpi, kam me ju bërë rrafsh të gjithëve’’ ku tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe raporton rastin në polici.

- me çka ka kryer vepër penale ‘’ kanosje ‘’ nga neni 181 par. 1 të KPRK-së,

Gjykata konform nenit 7, 38, 39,40,42, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69,70 nenit 184 par.2 dhe nenin 181 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

Për veprën penale të cekur në pikën I të dispozitivit :

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj,

Për veprën penale të cekur në pikën II të dispozitivit :

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj,

Andaj gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cilin dënim ndaj të pandehurit nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve për paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 (njëzet euro) €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar J. Th. nga fsh. G. K. P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1269/23, të datës 17.07.2023, ndaj të pandehurit J. Th, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.2, të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPP-së gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 12.12.2023 në praninë e prokurorit të shtetit L. H, të pandehurit J. Th., së bashku me mbrojtësin e tij av. F. B, sipas autorizimit, palës së dëmtuar A. Th, ndërsa pala e dëmtuar J. Th. është ftuar në mënyrë të rregullt për seancë mirëpo i njëjti nuk është paraqitur.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 të KPPK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës ka të angazhuar.

Pas leximit të aktakuzës PP/IL.nr.1269/23 të datës 17.07.2023 nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi që është i bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia që të deklarohet në lidhje me pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë e pranimin të fajësisë dhe pasojat e mospranimin.

I pandehuri J. Th. deklarojë që e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, duke shtuar se me palën e dëmtuar i kanë përmirësuar raportet si dhe së shpejti do të jetojnë së bashku, duke i kërkuar falje të dëmtuarës në prani të gjykatës, duke shtuar se këta janë familja e tij dhe do të jenë deri në frymën e fundit, duke e bërë pranimin e fajësisë vullnetarisht pa asnjë presion.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, deklarojë që ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësja e viktimave Z.B. në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklarojë që e përkrahim në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit dhe pajtohen me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, raportet familjare janë përmirësuar, pala e dëmtuar nuk kërkon kompensim dëmi.

Pala e dëmtuar A. Th. deklarojë që pajtohet me pranimin e fajësisë, raportet i kanë përmirësuar, nuk e ndjen veten të rrezikuar, duke shtuar se është e gatshme që të jetoj në bashkësi familjare, nuk ka kërkesë për kompensim dhe heq dorë nga ndjekja penale.

Mbrojtësi i të pandehurit J. Th, av. F. B. deklarojë që meqenëse i mbrojturi i tij J. Th. e bëri pranimin e fajësisë, ky pranim propozoj gjykatës që me rastin e marrjes e vendimit të i vlerësohet si rrethanë lehtësuese. I njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë pa mashtrim, kërcënim, lajthim po duke i kuptuar pasojat dhe rëndësinë e pranimin të fajësisë. I nderuari gjyqtar gjithashtu propozoj që lidhur me të mbrojturin tim të vlerësohen edhe këto rrethana kërkim falja pendimi i thellë, rrethanat që i njëjti nuk ka të kaluar kriminale që nënkupton se i njëjti nuk është recidivist i asnjë vepre penale deri më tani, rrethanën që e dëmtuara bashkëshortja e të mbrojturit tim u deklarua në mënyrën më të sqartë dhe vullnetare që pranohet, pranimin e fajësisë, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi, si dhe rrethanën që e njëjta u deklarua që ka vullnet të kthehet me të mbrojturin tim dhe të vazhdojnë jetën e përbashkët si person. Meqenëse tash fëmijët e tyre të përbashkët janë rritur janë nëpër shkolla dhe punë, i duhet edhe pak kohë për gjetjen e modalitetit se si do të vazhdojnë të jetojnë së bashku me fëmijët e tyre por për faktin nga vendi dhe fshati ku jetojnë i mbrojturi im është largësi nga vendi dhe shkolla e fëmijëve të tyre të përbashkët dhe i duhet modalitet në mënyrë më të sqartë të mundeshim qoftë të zhvendosen që të gjithë në Pejë aty ku është interesi i fëmijëve apo të kthehen në fshatin ku

jeton i mbrojturi im. E ri konfirmoj qëndrimin e të mbrojturit tim që kjo ka ndodhur aksidentalisht sepse nga 25 vite martës midis të mbrojturit tim dhe bashkëshortes së tij vetëm ajo ditë mbahet mend që janë përparë me fjalë asnjëherë deri më tani nuk kanë pasur mosmarrëveshje dhe dhunë në familje që për mua si mbrojtës më bënë tej mase krenar që të jap këtë mbrojtje dhe në fund të falënderoj publikisht bashkëshorten e të mbrojturin tim e cila ishte korrekte në pyetjet e gjykatës, që nuk kërkoj që i njëjti të dënohet, nuk kërkoj kompensim dëmi dhe nuk i' u bashkëngjijt ndjekjes penale. Nuk dua të shtoj më tepër vetëm i propozoj gjykatës që të analizoj dhe peshoj një nga një rrethanat lehtësuese dhe veçanërisht lehtësuese lidhur me të mbrojturin tim.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 dhe par. 6 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza edhe atë: raporti fillestar i incidentit i datës 09.07.2023, nr. rasti, raporti njoftues i përpiluar nga zyrtari policor T. H, i datës 09.07.2023, raporti i oficeres A. S, i datës 09.07.2023, nr. rasti, procesverbali i marrjes në pyetje i të dëmtuarit J. Th, i dhënë në Stacionin Policor në P, me datë 09.07.2023, nr. rasti ..., procesverbali i marrjes në pyetje i të dëmtuarës A. Th, i dhënë në Stacionin Policor në P, me datë 09.07.2023, nr. rasti, procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit J. Th, dhënë në Stacionin Policor në P, me datë 09.07.2023, nr. rasti, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj gjykata konform nenit 242 par.6, mori aktvendim me të cilin pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit J. Th. për veprën penale sulmi nga neni 184 par.2, të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.1, të KPRK-së.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit J. Th. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale sulmi nga neni 184 par.2, të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.1, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të pandehurit ashtu që i njëjti është penalisht përgjegjëse. Sa i përket fajësisë së të pandehurit, i njëjti është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, përmirësimin e raporteve me palën e dëmtuar A. Th, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe ka të bëjë rehabilitimin e tyre; të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.6, të KPPRK-së, gjykata ka obliguar të pandehurin që në emër të shpenzimet për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë euro) €.

Konform nenit 449 par 2 nën par. 2.9 të KPPRK-së dhe nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e udhëzoi palën e dëmtuar në kontest civil konform nenit 462 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata e përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 569/23 datë 24.12.2023

Bashkëpunëtoreshë Profesionale
Kaltrina Rexhepi - Imami

GJYQTARI
Veton Ademaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.